

COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #3

Veprimet dhe pajisjet e farmacisë: garantimi i sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimit

Mbikëqyrja profesionale/administratori i farmacisë

Në rast se administratori i farmacisë nuk mund të sigurojë praninë dhe rolin e tij / saj në farmaci, këto mund të merren nga një farmacist i dytë i cili mund ose nuk i përket personelit të farmacisë.

Oraret e hapjes

Në rast se një farmaci nuk mund të sigurojë hapjen e aktivitetit në orët e saj normale të hapjes në mungesë të stafit për shkak të COVID-19, oraret e reja të hapjes duhet t'i komunikohen publikut në një vend të dukshëm të paktën jashtë farmacisë.

Shërbimi i pacientit/klientit

Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit të barnave dhe shërbimeve për zonat ku ka vetëm një farmaci në një rreze të caktuar (e cila mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin), kontakti me pacientët / klientët duhet të minimizohet duke shpërndarë barna përmes një dritareje të vogël në fasadë ose derë, si ato që përdoren shpesh për shërbime të natës.

Një mburojë plastike gjithashtu mund të vihet përpara zonës së shpërndarjes, ose shenja të vendosura në tokë për të treguar distancën 1-2 m ndërmjet klientëve dhe stafit.

Në rast se asnjëra prej këtyre masave nuk është e mundur, pacientët / klientët nuk duhet të hyjnë në farmaci dhe farmacistët këshillohen të përdorin pajisje të përshtatshme mbrojtëse individuale, përfshirë maska dhe syze, kur është e nevojshme.

Për të shmangur mbipopullimin e njerëzve brenda farmacisë, pacientët dhe klientët duhet t'u kërkohet që të presin radhën e tyre jashtë farmacisë. Në çdo rast, pacientët / klientët duhet të mbajnë një distancë prej 1-2 metrash mes tyre duke pritur në radhë.

Furnizimi me barna

Kur është e përshtatshme, furnizimi i barnave në farmaci duhet të bëhet vetëm në prani të stafit të farmacisë, pa praninë e personave jashtë këtij stafi (ose të paktën zonat specifike të farmacisë ku nuk ka prani njerëzish të tjerë). Për më tepër, paketimet e përdorura nga importuesit dhe shpërndarësit për të furnizuar farmacinë duhet të pastrohen dhe dezinfektohen para se të futen brenda ambienteve të farmacisë.

Dorëzimi i barnave në shtëpi

Për të siguruar furnizimin e duhur të barnave për pacientët, dhe veçanërisht në qytetet e vogla ku mund të jenë mbyllur farmacitë përkatëse, farmacitë e hapura mund të organizojnë shpërndarjen në shtëpi të barnave. Farmacitë që janë në gjendje të ofrojnë këtë shërbim inkurajohen ta bëjnë këtë, veçanërisht për pacientët që mund të jenë në karantinë ose izolim në shtëpi, apo ata të cilët mund t'i përkasin një grupi më të lartë rreziku ose që nuk mund të levizin.

Në rastin e dërgesave në shtëpi, personi përgjegjës për dërgesën duhet të shmangë çdo kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin dhe objektet e tyre personale. Barnat dhe sendet e tjera mund të lihen jashtë derës së pacientit / klientit ose në një vend tjetër të caktuar, dhe dorëzuesi duhet të lëvizë për të mbajtur një distancë të sigurt prej 1-2 metrash duke siguruar vizualisht që barnat mblidhen nga pacienti ose një person i autorizuar.

Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në www.fip.org/coronavirus

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.

